

PANAJOT ZOTO
VDEKJA E NJË BOTE
TREGIME DHE SKICA

BOTIMET TOENA

PANAJOT ZOTO

VDEKJA E NJË BOTE

tregime dhe skica

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare dhe përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Lefter Çeko

ISBN 978-9928-348-73-9

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

ZINATJA DHE MURTINI

Unë jam e sotmja, njëherësh dhe e djeshmja. Jetoj përditë në të shkuarën dhe risjell në të sotmen ngjarjet që kam përjetuar. Kam jetuar në fshatin tim, Muzinë, prej aq vitesh e shekujsh sa nuk i mbaj më mend. Veç di se kam ndryshuar bashkë me të, që nga krijimi, duke përjetuar rritjen, mpakjen, shkatërrimet dhe ringritjet, deri në ditët e sotme. Herët: shekuj e shekuj më parë, më thërrisnin Admin. Më pas, Nik..., Nik Pali. Kur erdhën osmanët, unë, dhe të gjithë ne si fshat, bëmë qëndresë dhe nuk pranuan të ndryshonim fenë dhe emrat tanë. Në të kundërt i krishtëruam ato në përmbajtje emrash ortodoksë. Nikolla ishte emri im i fundit, por njihesha si Niko ngaqë ne në fshat përdornim shkurtimin e emrave...

... Muzina ka qenë aty, mbase edhe për 2000 vjet të shkuara, ngritur në tri kodra përballë shpatit jugor të Malit të Gjerë. Por jo si sot, as si gati një shekull më parë. Ishte si një botë më vete, që komunikonte me rrugën e kalldrëmtë, e cila ngjitej nga Grapshi

përgjatë dhe bri përroit deri në qafë, e, pastaj më tutje deri në Delvinë përmes një monopati, që niste nga vendi i quajtur “Shegëz” e që lidhej me rrugën e karvanëve përmes një ure druri në kapërcim të përroit, që zbret nga qafa dhe vjen e thellohet deri poshtë në rrjedhje të Bistricës. Që në kohën kur këto troje, ku përfshihej dhe ky vendbanim, emërtoheshin “Epir” e deri në ditët e sotme, askush nuk i ka dhënë dum pyetjes se përse ky fshat e ka marrë këtë emër... Të parët e mi tregonin se këto treva, ku përfshihej edhe ky fshat, edhe pse fytyra e Epirit të lashtë ndryshoi njëfarësoj, nuk pësuan ndryshime në përbërjen etnike. Thuhej se të parët që banuan këtu ishin ardhës nga malësitë e Thesalisë, dhe, më pas, dy fise nga vendbanimet përgjatë lumit Thyamis (Çamëria e sotme). Thesaliotët u vendosën fillimisht në një vend të pyllëzuar, aty ku shpati perëndimor i malit Stugarë zbret, dhe takohet me pyjet në afërsi të burimeve të Bistricës, që njihet si “Gropjetoshe”. Ndërkaq, fiset e ardhura nga vendbanimet përgjatë lumit Thyamis, vendvendosjen e tyre e emërtuan “Shqopë”, për shkak se e gjithë sipërfaqja e kodrës, dhe pllajat, në dhjetëra hektarë, nga veriu në kufi me kodrën e mesit deri në kufi me pyllin e gështenjave në jug, ishte veshur me bimën e shqopës. Fillimisht shpyllëzuan një sipërfaqe ku ndërtuan banesat dhe më pas, gradualisht, në vitet e shekujt që pasuan, sipërfaqe të tëra në pllajën që shikon nga perëndimi u zhveshën nga bima e shqopës dhe u mbollën me vreshta, me ullinj e pemë frutore.

Një sipërfaqe e konsiderueshme me bimë shqope u ruajt, sepse shqopa për ata banorë nuk përdorej vetëm si dru zjarri për ngrohje apo për të djegur kaminat e gëlqeres, por më shumë e donin për gjethen dhe lulet e saj të bukura në ngjyrë rozë, vjollcë dhe të bardhë, të cilat i përdornin, shpesh, edhe si ornamente për zbukurime të ndryshme dhe kryesisht për të prodhuar me to çajëra, sepse që në lashtësi kjo bimë konsiderohej si një kurë popullore. Të vjetrit thoshin se çaji i shqopës e bën trupin (organizmin) “të shkëlqejë nga pastërtia”.

Fiset e vendosura në “Gropjetoshe” dhe në “Shqopë”, u lidhën në miqësi edhe përmes martesave të shumta, por njëra prej tyre do të mbetej e do të përmendej në vite e shekuj më pas, si një rast që shpjegon edhe enigmën e prejardhjes së emrit të fshatit. Zinatja, vajza e dy prindërve thesaliotë dhe Murtini, djali i dy prindërve prej fisit të ardhur nga vendbanimet përgjatë lumit Thyamis, ishin njohur e rritur bashkë, që fëmijë, dhe në adoleshencën e tyre ndien brenda vetes një lloj afërsie tjetër. Ata u dashuruan dhe kërkuan martesë nga prindërit, të cilët pranuan. U bë një dasmë e madhe, dhe në darkën e shtruar, ku vera e prodhuar nga rrushi i vreshtave të mbjella në ato pllaja, rridhte si lum, më i vjetri në moshë ngriti dollinë e parë: “Po martojmë djemtë tanë, Murtinin me Zinatjan. Bashkimi i tyre në çift na jep mundësinë të bashkojmë emrat e tyre, bashkim i cili do na bëjë një, banorë të një fshati, me një emër të

ri. Le ta pagëzojmë fshatin e ri me emrin “Murzina”. Të gjithë brohoritën dhe duartrokitën, duke pranuar kësisoj që fshati i ri i tyre të kishte këtë emër.

Po kur turmat e invazorëve sllavë iu vërsulën tokave të perandorisë, duke shkatërruar gjithçka dhe zhytur në gjak Ilirinë, Epirin dhe Thesalinë..., gjërat nisën të ndryshojnë. Fshati shpëtoi nga shkatërrimi, falë vendndodhjes mes pyjeve dhe larg rrugëve lidhëse me qytetërimin e kohës. Mbetën këtu vetëm disa fise sllave, që, gjithsesi, diktuan për vite e, pse jo dhe për shekuj forcën e tyre mbi banorët. Thuhet se ata ia vunë emrin vendqëndrimit të tyre, në kodrën pranë pikëtakimit të Malit të Gjerë me Stugarën, “Muzinac”, sepse këtë emër kishte fshati nga ku ata zbritën prej vendbanimeve të Ballkanit Veriperëndimor. Ky emërtim u trashëgua në vitet e shekujt e mëpasshëm, sikundër dhe disa emra vendesh, si “Vodëla”, “Bagrene”, “Gribo”, “Çorogje”, “Dumo”, “Manalet”, apo “Bistrica”, që në kohët më të vjetra i thoshin “Simoi”. Por banorët vendës nuk u asimiluan, përkundrazi. Mbijetuan duke ruajtur besimin, zakonet si edhe doket e hershme. Koha bëri vetëm një gjë: bashkoi emrin sllav “Muzinac” me emrin “Murzina”, duke ua përcjellë brezave emrin e sotëm “Muzina”.

POLEMI

Kur burrat e Muzinës shkuan vullnetarë për ndërtimin e manastirit, në vendin e quajtur Ipsilispetras (shkëmbi i lartë), në Cepo, një pari e fshatit Pecë ishte takuar me grupin e rojtarëve, që ruanin qafën ku kalonte rruga e karvanëve nga Bregdeti e Delvina për në Gjirokastrë e Janinë, dhe u kërkuan atyre hisen (pjesën) e fitimit nga kjo punë, sepse - thanë ata - “ky territor, e gjithë pllaja e malit, gjer në kufi me fshatin Grapsh, i takon Pecës”. U grindën me fjalë, u nxehën gjakrat, por vetëm kaq. Peciëtët u thanë rojtarëve se kërkonin një zgjidhje paqësore për kufirin mes dy fshatrave, dhe ikën. Le ta pleqëronin kur burrat të ktheheshin nga Cepua...

Të urtët e të dyja fshatrave ishin takuar, në vite e shekuj, për të gjetur paqësisht një zgjidhje për kufirin ndarës mes dy fshatrave. Paria e fshatit Muzinë këmbëngulte se kufiri duhej të mbetej tej, në përfundim të “vreshtit të Dedës”, atje ku shpati i malit zbret deri poshtë, dhe aty ku përroi krijon një ndarje të natyrshme... “Jo!”, këmbëngulte paria e fshatit Pecë. Ata pretendonin shumë. Kërkonin të kontrollonin rrugën e karvanëve, qafën, dhe të zotëronin gjithë

shpatin e Malit të Gjerë, për ta përdorur për kullotë dhe lëndë drusore. Viti, në kapërcim të mijëvjeçarit të parë pas Krishtit, shënoi disa ballafaqime mes banorëve të të dyja fshatrave në mosmarrëveshje për kufirin ndarës. Takim pas takimi dhe pa një marrëveshje të pranueshme, puna arriti deri në ballafaqim force. Fshati i shtoi rojat, një numër i të cilëve qëndronin natë e ditë te sheshi i “vreshtit të Dedës”, dhe, përballë tyre kërcënonin me përdorim force burrat e fshatit tjetër, Pecës, që donin ta shtynin kufirin përmes rrugës së karvanëve, tej qafës, deri në vendin e quajtur “Përroi i Grapshit”. Me gjithë paralajmërimet e parisë së fshatit Muzinë, peciotët nuk hiqnin dorë, derisa, në një rast, burrat e të dyja fshatrave u ndeshën duke përdorur ndaj njëri-tjetrit shkopinje e gurrë. Kjo e acaroi dhe më shumë situatën, kështu paritë e të dyja fshatrave shpallën “gjendjen e luftës” mes tyre.

Fshatrat mobilizuan burrat dhe djemtë më të fortë. Muzinjtëve u printe djaloshi nga mëhalla e kodrës, Nik Deda... Disa ditë burrat e të dyja fshatrave u ndeshën tek ai shesh, ku përdorën mbi njëri-tjetrin, hunj e shkopinje të përgatitur enkas për luftën mes tyre, dhe asnjëra palë nuk tërhijej. Kur dita ngrysej e binte qetësia, dhe nata bënte hesapet e pësimeve, gratë, merreshin me të lënduarit, kurse burrat pushonin për të fituar energji për ndeshjen e së nesërme... Thuhet se më pas, në atë përballje, u përdorën edhe kosore, sëpata dhe mjete të tjera të forta, pati edhe të vrarë e

të gjymtuar. Armëpushimi mes dy fshatrave u vendos pas ndërhyrjes së një përfaqësuesi të despotatit të Bregdetit, pjesë e të cilit ishin dhe këto dy fshatra. Pecioteve iu lanë kullotat në pllajat e pasura me bar në shpatin e malit, ndërsa u pranua që kufiri (rrugor) mes dy fshatrave të mbetej te sheshi, në “Stanin e Qirjaqit”, vend të cilin, fshatarët e Muzinës dhe të Pecës e “pagëzuan” me emrin “Polemi” (luftë).

Pastaj erdhi paqja, që solli në vite e shekuj miqësi të reja mes fiseve e familjeve muzinjote e peciote, përmes lidhjeve martesore të djemve e vajzave, por dhe bashkimit të përpjekjeve për të mbrojtur identitetin dhe për të ruajtur zakonet e gjuhën. Muzina kishte një të folme të veçantë të shqipes, dhe të parët, jo rrallë, e përzienin shqipen me fjalë të gjuhës greke. Në fakt ishte një fshat dygjuhësor, dhe në të dyja gjuhët përdorej një e folme me fjalë specifike... Në një nga ditët e përleshjeve të burrave të të dyja fshatrave për kufirin, ku kishte edhe të lënduar, u mbledhën në shtëpinë e Gjikatëve, në Mesomahallë (lagjja e mesit) gratë e fshatit, për t’u qëndruar afër njerëzve të shtëpisë dhe për të shprehur keqardhjen e tyre për ç’u kishte ndodhur. “Ah *mo e shuar* ç’pësove, po mos u *sillois*. Perëndia është e madhe”, i thoshte njëra nga gratë, *gjiklës*, gruas së shtëpisë. Pastaj një tjetër: “Nesër, *proi-proi*, të vemi në Shënthanas, të hapim derën e *klishës*, të *proshqinisim* e t’i lutemi perëndisë”. Ndërkaq vajza e vogël e burrit të shtëpisë të plagosur nuk pushonte së qari, aty te koka e

babait, te shtrati në *gone*, dhe gratë mundoheshin ta qetësonin, por më e moshuara i tha: “*Mall klave*. Do marrim hak mbi ta. *U*, dhe gratë e tjera do të nisemi bashkë me burrat tanë t’u biem *jezitetëve* peciotë, *pa le të vejë* gjaku gjer në *glu...*”

Në ditët tona gjërat kanë ndryshuar. “Polemi” është aty, por jo më si kufi ndarës mes dy fshatrave, por veç si një toponim, që si çdo toponim e ka një histori, a gojëdhënë ardhur nga lashtësia, qoftë dhe si legjendë.

Shtëpia trekatëshe e Anagnostëve dallohej ndër të tjerat, jo vetëm në Shqopë, mëhallën me dendësi shtëpish dhe rrugicat e sheshta të kalldrërmta. Shtëpia, në hyrje të mëhallës, kishte një hije të rëndë, pasi atje mbledhej paria e fshatit që kishte në krye, vite e vite me radhë, burra të lindur e rritur atje, mes atij gjelbërimi të bahçeve që rrethonin shtëpinë me oborr të gjerë, të shtruar me pllaka, dhe sofatin e portës së madhe me qemer guri të skalitur. Te kjo portë trokiti, një ditë dimri, një i panjohur, i ndjekur nga vështimet kureshtare të fëmijëve të lagjes, që po lodronin te sheshi i shtëpisë së Verlëve. Portën e hapi një nga nuset e shtëpisë, por e mbylli sapo pa të panjohurin mjekrosh me një pisqollë dhe shpatë të ngjeshur në brez. I panjohuri, që nuk arriti t'i prezantohej, pasi ia përplasën portën e rëndë pas fytyrës, i ra asaj më me forcë. Gruaja kishte vrapuar për të lajmëruar burrat e shtëpisë për njeriun që ishte pas porte, ndërsa të goditurat e portës së drunjtë me grusht, dëgjoheshin gjer lart në dhomën ku ishte mbledhur paria e fshatit.

- Ç'ka ndodhur që je kaq e nxituar? - pyeti i zoti i shtëpisë gruan, sapo ajo hapi me nxitim derën dhe u bë gati të fliste:

- Një i huaj, i armatosur...

- Ai i bie si i marrë portës? - e ndërpreu i zoti i shtëpisë. Gruaja e re nuk foli veç tundi kokën si për t'i thënë "po", ndërsa i pari i shtëpisë u hodhi një vështrim burrave të ulur në shiltetë e dhomës dhe urdhëroi të hapej porta. U ngrit në këmbë dhe u tha burrave ta ndiqnin...

- Jam Aliu, djali i Veli Beut të Tepelenës..., - u prezantua i panjohuri, që kishte një shtat të derdhur dhe trup të bëshëm, flokë të gjatë në ngjyrën e grurit të majit, dhe sy në ngjyrën e detit.

- Eja, eja futu... Këtu je si në shtëpinë tënde, - tha i pari i shtëpisë, dhe e pyeti se ç'hall e kishte sjellë te porta e shtëpisë së tij. Aliu, në atë kohë një djalë që nuk i kishte kapërcyer të njëzetat, plot energji dhe me shkathtësinë që e karakterizonte, u përul paksa, dhe me një buzëqeshje të çiltër i falënderoi burrat që e rrethonin, duke u thënë se kohën nuk e kishte aleate. Kureshtar, ata e pyetën se përse nxitonte dhe çfarë kërkonte.

- Më ndjekin koshadhet e Kurt Pashait. Arrita t'iu shmangem sapo kalova qafën. U fsheha te përroi i madh poshtë rrugës së karvanëve, ku kam lënë edhe kalin, - u shpjegua i riu, dhe u kërkoi burrave besën. Ata panë njëri-tjetrin heshturazi dhe nuk folën. Kishin dëgjuar për bëmat e këtij djaloshi. Ishte vetëm 16 vjeç

kur e kishin kapur në malet e Pindit të Greqisë, në një aventurë plaçkitëse, dhe e kishin dorëzuar te pashai i Janinës. Nuk ia prenë kokën, siç parashihte ligji, falë ndërhyrjes së bejlerëve gjirokastritë e delvinjotë, te pashai. Këtë histori e dinin ata burra, që nuk kërkuan më shpjegime, të bindur se edhe në këtë rast përndjekja e tij ishte për një tjetër aventurë.

- Ç'na kërkon zotrote efendi?- e pyeti pastaj plaku Anagnost Muzina.

- Të më fshihni diku dhe të kyçen gojët e fshatit, - tha djaloshi.

- Je në besën tonë, - folën në një gojë burrat e parisë së fshatit, dhe e pyetën se ku donte të strehohej. Të gjithë ishin të gatshëm ta mbanin në shtëpi djaloshin namëmadh, por ai nuk pranoi duke u thënë se kërkonte një strehë atje ku nuk kishte tjetër më të madh se ai.

- Jooo! Nuk ka ndër ne tjetër më të madh, o madhëri. Më i madhi je ti. Ne jemi thjesht fshatarë, -tha njëri prej tyre. Aliu qeshi dhe i falënderoi. Ndërkohë burrat e parisë u mblodhën kokë më kokë, diçka biseduan, dhe me një tundje koke në shenjë dakordësie, u kthyen nga djali i Veli Beut.

- E kemi një vend të sigurt. Shtëpia ka vetëm një grua të ve, - i tha plaku Anagnost.

- Vetëm fëmijë të mos ketë, të tjerat s'kanë rëndësi. Shkojmë pa vonuar sepse çdo vonesë e shton rrezikun, - tha djaloshi rebel dhe u nis i pari. Pas tij plaku i Naçanjve, që e shoqëronte, kureshtar e pyeti "përse i druhash fëmijëve", dhe ai iu përgjigj: "Sepse ata nuk

dinë të ruajnë të fshehta, pa dashur mund t'i japin gojës më shumë dhe, llaf pas llafi, lajmi merr dhenë”.

Pa rënë nata ia kishin behur në fshat njerëzit e Kurt Pashës. U ranë dyerve dhe bënë kasht' e koqe çdo shtëpi. Kur ata kishin hyrë në oborrin e shtëpisë së vejushës, Aliu i kishte parë nga një dritarezë e tavanit, ku qëndronte i fshehur; dhe bëri pishqollën gati për çdo rast. Njerëzit e pashait të Beratit përmbysën gjithçka, shtrënguan gruan e ve t'u tregonte nëse kishte parë një djalë mjekrosh me flokë të verdhë, dhe si u bindën që në atë shtëpi ishte vetëm gruaja e ve, u larguan...

Në ditën e shtatë të “burgosjes” në tavanin e asaj shtëpie, dy burra të parisë së fshatit shkuan për t'i dhënë lajmin e mirë djaloshit. Njerëzit e Sanxhakbeut të Delvinës ishin përhapur gjithandej dhe lajmëronin nëpër fshatra se djali i Veli Beut, Aliu, ishte i lirë, dhe mund të dilte në mexhëlis. Kishte ndodhur e njëjta gjë. Bejlerët e Gjirokastrës dhe ata të Delvinës, kishin ndërhyrë dhe Kurt Pashai ia kishte falur jetën djaloshit nga Tepelena... Kaluan vitet dhe Aliu i Tepelenës, që ishte martuar me vajzën e Sanxhakbeut të Delvinës, Kapllanpashallit, Ymi Gyldim Hanëmin, u bë i njohur për forcën e fjalës dhe trimëritë e tij në të gjitha angazhimet luftarake dhe detyrat e ngarkuara nga porta e lartë. Por, aq sa merrte famë emri i tij, aq pranë ia sillte kujtesa fshatin Muzinë dhe njerëzit e saj, dhe me vetveten kishte marrë një zotim për t'ua shpërblyer gjithçka që ata kishin bërë dy e ca dekada

më parë për të... Tani ai qëndronte, i madhërishëm, në fronin e Valiut të Janinës, i emëruar nga Porta e Lartë. E kishte shtënë në dorë Janinën, pasi ia kishte dalë të mposhte rivalitetin e Ali Izet Pashë Kurtit, të parin e Alizotëve, duke mënjanuar dhe anëtarin më të shquar në atë kohë të Asllanpashallinjëve, Ymer Beun.

Një ditë shtatori të vitit 1790 kishte mbërritur në Muzinë një shpurë kalorësish, të cilët, pasi lidhën kuajt te hani në qafë, pyetën hanxhiun se si dhe ku mund të takoheshin me parinë e fshatit. “Kemi një haber nga Ali Pasha”, kishte thënë i pari i tyre. “Këtu, në këtë han”, u përgjigj hanxhiu dhe dërgoi lajmëtarë në fshat për të parin e parisë, qirje Kostën. Të dërguarit e Pashait, pas përshëndetjeve të rastit, u thanë përfaqësuesve të fshatit se ata vinin në emër të Ali pashait, i cili ishte gati për ta ndihmuar fshatin. “Pashai na tha se kishte një borxh për të shlyer, ngaqë vite më parë ju e keni strehuar duke i shpëtuar jetën. Nderin ai do t’ua kthejë me nder. Ç’kërkoni nga pashai?”, tha i pari i dërgesës nga Janina.

Burrat e parisë së fshatit, nuk ishin ata të para njëzet e ca viteve, megjithatë e dinin historinë e djalit të dikurshëm. Të befasuar nga lajmi që vinte, pa e pasur kurrë në mendje dhe as që e prisnin një gjë të tillë, diskutuan mes tyre për pak çaste dhe, qirje Kosta tha:

- Ne i përulemi pashait dhe e falënderojmë për dashamirësinë. Kjo na mjafton.

- Jo, jo. Pashait i mbetet qejfi nëse ju nuk do të pranoni një shpërblim prej tij, prandaj na thoni ç'kërkoni nga pashai, - tha i pari i kalorësve.

Burrat e parisë së fshatit u mbledhën sërish kokë më kokë, debatuan mes tyre disa minuta dhe më së fundi vendosën. Qirje Kosta u tha se nuk donin gjë tjetër veçse të ishin të lirë. Fshati të mos bëhej çiflig i askujt, por dhe të përjashtohet nga taksat. “Jemi rreth 90 familje dhe paguajmë mbi 12000 akçe vjetore, që nuk janë pak për ne”, tha ai, duke shtuar dhe kërkesën që shkolla në gjuhën greke, e hapur pak vite më parë, të mos prekej. Të ardhurit mbajtën shënim dhe pa bërë asnjë kundërshtim, falënderuan parinë dhe u larguan...

Ali Pasha e firmosi pa hezitim fermanin, që plotësonte kërkesat e parisë së Muzinës, fshat i cili mbeti, pas kësaj, i lirë dhe i privilegjuar nga taksat.

Vitet do të kalonin dhe sërish Ali Pashai do ta kujtonte dhe respektonte këtë fshat mikpritës, me të cilin ishte lidhur shpirtërisht pas asaj që kishte ndodhur në rininë e tij, kur paria e fshatit e kishte strehuar dhe shpëtuar nga përndjekja e njerëzve të Kurt Pashait. Edhe pse kishte kaluar një gjysmë shekulli, dhe tashmë, djaloshi i dikurshëm flokëverdhe ishte

në një moshë të thyer, mendja dhe epsheet e tij rinore mbeteshin të freskëta. Nuk e harroi Muzinën edhe në martesën e katërt të tij me 16-vjeçaren Vasiliqi, bukuroshen nga Pleshevica e Filatit. Kishte kaluar andej me një mision për kapjen e falsifikatorëve të monedhave, kishte parë në një shtëpi të fshatit atë mrekulli, vajzën e një fshatari të Çamërisë, dhe e kishte marrë me vete. Lajmi ishte përhapur gjithandej, por askujt nuk do t'i shkonte ndër mend që pashai do ta martonte atë vogëlushe, kur vetë ai ishte një burrë plak 73-vjeçar. Po çfarë nuk bënte Ali Pasha?! Shpalli dasmën dhe dërgoi lajmës edhe në Muzinë. Kishte ftuar në dasmën e tij me Vasiliqinë një përfaqësi të fshatit.

Ishte mbledhur paria e fshatit dhe vendosi ta nderonte Pashanë me një përfaqësi, por dhe me një kamish (peshqesh) që numëronte 40 desh me këmborë. Kost Thanailati, kishte përzgjedhur deshët nga 10 tufat më të mira të deleve të fshatit, dhe bashkë me Tir Anagnostin dhe Thim Dedën, ishin nisur, tri ditë para dasmës, drejt Janinës. I përcollën pashait falënderimet dhe besnikërinë e muzinjtëve, dhe morën prej tij fjalën se nuk do t'i prekte kush... Kështu Muzina mbeti një fshat i lirë, pa agallarë e çifligarë duke mbetur vetë zot të fshatit dhe jetës së tyre.

SHESHET E VALLEVE

Kur e shikon nga larg, ngritur mbi tri kodra, fshehur në një gjelbërim mahnitës, syri nuk të rrok asnjë shesh, edhe se ato janë aty, dhe secili prej tyre ka një histori. Nga fëmijëria dhe adoleshenca ime e hershme, sjell ndër mend, sot sheshet e fshatit, aty ku loznim ne fëmijët, ku mblidhej gjitonia dhe fshati në festa, ku buçisnin këngët dhe dridhej toka nga vallet. Të gjitha kishin një paracukël: “Sheshet e valleve”.

Sheshi i kishës së “Shën Thanasit”, sheshi i rrapeve në “Kodër”, sheshi i “Shën Mërisë”, por edhe sheshi i “Kroit”, të gjitha kanë shkruar historinë e këtij fshati, kanë ndier drithërimën e shpirtit muzinjot dhe dashurinë që buronte nga brenda këtij shpirti. Sheshet kanë qenë “arena” miqësie dhe dashurie mes të rinjve, por dhe dëshmitarë të lidhjeve martesore mes tyre. Sheshet kanë “regjistruar” emra këngëtarësh e valltarësh, gojëtarësh e firmëtarësh të ndryshimeve në vite e shekuj. Historia e këtij fshati fshihet në thellësi të tyre, brenda asaj toke që ruan nostalgjitë tona.

Te sheshi i “Shën Thanasit”, mblidhej fshati çdo 27 mars, në ditën e “Vangjelizmoit”. Burrat e gratë këndonin e hidhnin valle. Të rinjtë, në çifte e grupe,

u binin këmborëve dhe zileve për të ndjekur bubat e gjarpërinjtë, dhe më pas mblidheshin te sheshi e ia merrnin këngës me një iso të shtruar sa ushtonte përroi i vusqeve dhe pylli përballë. Fëmijët niseshin që andej në grupe, të mbuluar me gjethe kulpre, trokitnin në dyert e shtëpive, dhe duke kënduar këngën e ritit të festës, prisnin të zotët që dilnin në sofate dhe dhuronin vezë. Ky shesh mblidhte fshatin edhe në mesjavën e qershorit të çdo viti, ku praktikohesh riti i zjarreve, të pasuara nga këngë e valle. Djem e vajza mblidhnin dru e shkarpa në pyll, ndiznin zjarre dhe kapërcenin flakët, duke kënduar këngët e riteve për largimin e pleshtave dhe morrave, dhe luteshin që muajt e verës të vinin pa to.

15 gushti, dita e “Panajasë”, mblidhte gjithë fshatin te sheshi i “Shën Mërisë”, pranë pyllit të gështenjave. Liturgjitë brenda mureve të kishës ndiqeshin nga të paktët besimtarë “besnikë të Zotit, lart”, siç thoshin muzinjtët e shumtë, që mbushnin sheshin para kishës. Këngët dhe vallet ushtonin tek ai shesh, ku përzihej gjelbërimi i atij peizazhi të natyrës me ngjyrat e kostumeve popullore, ku fëshfërima e fustanellave të bardha të burrave kishte ndjesinë e puhizës së fladit, që dërgonte pylli i gështenjave, ndërsa allaxhatë e grave sillnin ngjyrat dhe aromën e këndshme të luleshqopës. Vajzat dhe djemtë kryqëzonin vështrimet dhe zgjidhnin duart që do të kapnin në vallet, që të krijonin rrathë të tjerë e kështu të zgjeronin rrathët e valleve të burrave dhe

grave. Ndërkaq fëmijët hokatarë vraponin e lodronin pa pushim, gjer në perëndim të diellit, kur turmat e njerëzve e linin sheshin në shenjtërinë e tij dhe largoheshin duke kënduar, në pritje të një tjetër dite me punët dhe hallet që ndiqnin jetët e tyre...

Kur pranvera ia linte vendin verës së nxehtë, dhe uji i vusqeve shteronte, kroi i fshatit fshehur në pyllëzim e përroit, që zbret nga kisha e “Shën Mërisë”, priste, në një freski fladitëse, nusët dhe vajzat e reja që merrnin prej tij bashkë me ujin edhe kënaqësinë e takimeve dhe ëmbëlsinë e joshjeve të djemve, që ndiqnin karvanët e kafshëve në rrugëtimin e tyre për te kroi... Në pritje të mbushjes së bucelave me ujin e freskët të burimit, mbledheshin te sheshi i vogël ndanë rrjedhës së ujit vajzat dhe nusët e reja, dhe ia nisnin këngës: *Mos ri silloisuro, bil e nënës/ Ti thëllëz e malito, merrja këngës...* pastaj kapeshin për dore dhe hidhnin valle duke kënduar. Zërat e tyre drithërues dhe isoja e shtruar melodioze bashkohej me cicërimat e zogjve në një kor që dëgjohej gjer tutje vreshtave mbi Syrin e Kaltër. Tek ai shesh i vogël, ndanë rrjedhës së ujit që fladitej nga fëshfërimat e gjetheve dhe nga era e lulekulprës, jo vetëm në fëmijërinë time, por në thellësi të viteve, ka vijuar i njëjti ritual i valleve dhe këngëve. Atje kanë lindur dashuritë që mbanin në gji lëngun e jetës.

ATJE KU BURON BISTRICA

Muzina ka tri mëhalla (lagje) dhe tre përrenj si kufi që ndajnë mëhallët nga njëra-tjetra. Ato janë zgjatim i lugjeve që zbresin nga mali, në këmbët e të cilit ngrihet fshati dhe bashkohen në “Përroin e madh”, që mbledh, dimrave, vërshimin e ujërave nga prurjet e shumta të malit, për t’i derdhur ato në Bistricë. Ne, fëmijët e fshatit, e përdornim shpesh shtratin e “Përroit të madh” si një rrugë për të shkuar në lumë, edhe pse kalonim nëpër rrëpira të frikshme, zgjatim i kodrinave në ngjyrën e tjegullës, që ne i quanim “Kungjet e Pecës”. Në fakt rruga për të shkuar te lumi nuk ishte kjo. Ajo zbret poshtë vendit të quajtur “Ura e Shqopës”, kalon (sot nuk shkon askush andej) poshtë kopshteve të mbjella me pemë frutore, vreshta e ullinj dhe dredhon nëpër kokojkat e brezareve pa bimësi, ku mund të kalonte vetëm një njeri, apo një kafshë ngarkese.

Muzinjtët e kishin lidhur jetën e tyre me lumin. Atje zbrisnin gratë e fshatit, përditë, nga fillimi i pranverës gjer në fillimin e shirave të vjeshtës, me kafshët ngarkuar me tesha apo gjineshtër. Atje i

kalonin ditët duke larë rrobat në lumë, dhe duke nxjerrë lëkurën e gjineshtrës, të cilën e mbanin të zhytur në ujë ditë të tëra për t'u zbrujtur. Ne fëmijët u shkonim pas, si qengja, nënave apo gjysheve, dhe kënaqeshim duke kaluar gjithë ditën me lodra. Kridheshim në ujin e ftohtë të bullandrës, ku ende ishin në këmbë muret e mullirit të vjetër, qëndronim për "t'u tharë" pranë zjarreve, që gratë ndiznin për të ngrohur ujët në kazanët e rrobave. Dëgjoheshin njëherësh: uturima e lumit që vinte me nxitim nga lart, bisedat tona të zhurmshme, dhe rrallë, kur ishim të vëmendshëm, edhe cicërimat e zogjve. Në perceptimin tonë fëmijëror lumi ishte si një shtëpi e madhe që na mblidhte të gjithëve. Dhe vërtet ai vend ku bënë hije rrapet shekullore, ishte një "fabrikë" larëse e përpunuese; "lavanderi" ku laheshin rroba, dhe "punishte", ku nxirrej lëkura e gjineshtrës, me të cilin nënat tona bënë zhaka, trasta, shtroje për dysheme, mbulesa krevatesh etj.

Gratë mblidheshin në grupe kur përpunonin gjineshtrën, e kalonin kohën duke kënduar, por më shumë duke biseduar, ose duke na treguar, neve të vegjëlve, përralla a gjëegjëza. Në njërën prej ditëve të atij behari përvëlues, nënë Marigoja na mori me vete për të na treguar Tharopinën. Kështu i thoshim ne muzinjtët Syrit të Kaltër. - I shikoni këto dy rrepe të larta? - tha ajo gjatë rrugës, dhe ndërsa ne ngritëm kokën lart, ajo psherëtiu dhe duke na shtrënguar fort pas vetes, tha se këtu i ishte vrarë burri. Ishte ngjitur në rrapin e lartë për të prerë një degë dhe ra poshtë

me gjithë të. Ishim të vegjël dhe nuk di se si reaguam. Mbaj mend që na përkëdheli dhe na tha të uleshim nën hijen e rrapit, mbi shkëmbin poshtë të cilit buronte një ujë në dukje i kaltër. Atje, nënë Marigoja na mblodhi rreth vetes, dhe na tha se Tharopina ishte një nga burimet e lumit. Më pas nisi të tregojë:

- Ka qenë në kohët e para, nuk mbahet mend se kur, një gjarpër i madh, që fshatarët i thoshin “Gjarpri Kuçedër”. E kishte follenë lart në mal, në prosil, dhe ishte zot i burimit të vetëm, te mulliri, ku zbriste për të pirë ujë një herë në javë. Atëherë uji ishte i paktë dhe fshatarët mbushnin ujë me radhë, por jo pa lot. Gjarpri Kuçedër u kërkonte fshatarëve kurban njerëzor, përndryshe nuk i lejonte të mbushnin ujë nga burimi i mullirit. Dikur fshati mbeti cullak, pa njerëz. Kur i ra radha, për t’u bërë kurban i Gjarpri Kuçedër, papo Pilos, që ishte mjeshtër i prodhimit të qymyrit nga drutë e pyllit të Shën Mërisë, që ishte më i mençuri i fshatit, thonë se u tund toka. Papo Pilo kishte mbushur thasët me qymyr, brenda të cilëve kishte futur eshkë të ndezur, kishte ngarkuar gomarin me to dhe ishte nisur për t’iu flijuar Gjarpri Kuçedër. Kishte qëndruar dhjetë metra larg folesë dhe kishte thirrur me të madhe: “O i madhi i Malit të Gjerë dhe zot i tokës dhe njerëzve të saj. Dil dhe më kollofit”. Gjarpri Kuçedër dëgjoi dhe nxori kokën nga foleja, por pa vetëm gomarin. Xha Pilon jo. Ishte fshehur pas një gëmushe . “Ku je o njeri!”, bërtiti Gjarpri Kuçedër, sa u drodhën gurët. “U rrokullis një shkëmb nga maja

e malit, dhe më goditi këmbën. Nuk mund të lëviz. Po ti, sa të zvarritem unë gjer atje, ke gomarin. Kollofite atë për sot dhe, deri nesër do të mund të vij atje”, i tha plakun... Teto Marigoja heshti pak, për të pushuar si pas një ecjeje të gjatë, ndërsa ne ia kishim ngulur vështrimet tërë kureshtje dhe të etur për të mësuar atë që vinte më pas, njëzëri pyetëm: - Po pastaj? - Pastaj, - tha ajo, - Gjarpri Kuçedër, sa hap e mbyll sytë kollofite gomarin me gjithë thasët, brenda të cilëve eshka digjte qymyrin, dhe kështu zjarri nisi avash-avash t’ia digjte plaçkat e barkut. S’kaloi shumë kohë dhe barku i Gjarprit Kuçedër u pushtua nga zjarri, që prodhoi qymyri, dhe ai bërtiti sa oshtinë malet. Kërkoj plakun duke thënë se do ta gjente kudo që të futej. Doli nga foleja dhe bërtiste e ulërinte për ujë, duke i kërkuar ndihmë detit dhe lumit: “Pu ise mana thallasa qe adhelpi Simoi!”, ku je nëna ime det dhe motra Simoi (Bistricë). Zbriti nëpër rrëpirat e malit, kështu duke u djegur, dhe, edhe pse deti iu afrua nuk mundi të ngjitej gjer lart. Doli dhe lumi nga gjiri i shkëmbit, por dhe ai nuk e arriti dot. Gjarpri Kuçedër mbeti atje lart. Thonë se u shkrumbua dhe kockat e tij janë përdorur si kolona në ndërtimin e manastirit të Mesopotamit.

Një “Uaaa...” e zgjatur doli nga gjokset tona si një thirrje habie. Dhe nënë Marigoja shtriu dorën në drejtim të malit dhe na tha se rruga e Gjarprit Kuçedër duket edhe sot. Atje ku ka kaluar gjarpri ende nuk mbin bari, ndërsa pemët kanë mbirë në të dyja anët

dhe gjatësinë e saj. - Po shkëmbi, nga i cili doli lumi ku është? - pyeti Vasili, shoku ynë. Teto Marigoja qeshi dhe tha se shkëmbi nga buron lumi ndodhej në të majtë të rrugës, jo më larg se 50 metra nga vendi ku rruga e fshatit takohet me lumin.

Ne nuk mund të rrinim pa vajtur te shkëmbi. Nga natyra ishim kureshtarë, por tregimi i teto Marigosë na e shtoi edhe më kureshtjen. Vendosëm të shkonim te shkëmbi pa u thënë prindërve, dhe pa marrë lejen e tyre. Në fakt kurrë nuk u kërkonim leje prindërve për aventurat tona, pasi vetë ata na kishin dhënë liri të vraponim, të loznim, të argëtoheshim sipas mënyrës sonë, madje të flinim edhe jashtë gjatë verës, nëpër lëmenjtë ku fshatarët shinin grurin... Asnjëherë nuk rrinim në qetësi dhe kjo na lumturonte.

U nisëm herët, para se çobani të lajmëronte për nxjerrjen e dhive në kullotë (shumica dërmuese e muzinjtëve mbanin dhi për qumësht e djathë), kur dielli kishte ndriçuar vetëm gjysmën e malit prosil dhe një pjesë të arave të Pecës. Ishim 5 shokë: Unë, Vasua, Miltua, Pandua dhe Dhimoja. Shkëmbi ishte në të djathtë të rrugës që zbriste në lumë. Nuk kishte rrugë për të shkuar atje, prandaj u ngjitëm kundër rrjedhës së lumit deri atje ku uji dilte nga toka, përfund atij masivi shkëmbor, dhe derdhej i shkumëzuar dhe i zhurmshëm teposhtë. U ngjitëm duke ecur me vështirësi nëpër ca rrugina, ku mund të kalonin vetëm dhitë dhe u ndalëm në faqen e shkëmbit ku dallohej një e çarë në një lartësi jo shumë të madhe

nga vendi ku ishim ndalur. - Futemi brenda, - tha Pandua, që dallonte për guximin e tij, dhe, i pari, u kap pas shkëmbit. U fut brenda tij përmes së çarës, pa vështirësi. - Hajdeni se na nxë, - tha. Ne, njëri pas tjetrit, u ngjitëm dhe përmes së çarës u futëm në një zgavër të madhe në brendësi të shkëmbit. Zgavra, një hapësirë goxha, pothuaj sa një dhomëz, komunikonte me një hapësirë tjetër poshtë saj, përmes një të çare në formë të çrregullt. - Do të futem unë, - tha Miltua, dhe u bë gati të zbriste, por nuk e lamë. Zgavra, ku po rrinim ishte në gjysmerrësirë, ndërsa përmes të çarës, nga ku mund të zbrisje më poshtë, nuk shikonim gjësendi, për shkak të errësirës. Vendosëm të dilnim nga zgavra dhe të vinim të nesërmen me qirinj e shkrepëse...

Dhe u kthyem, por tani jo me qirinj. Kishim marrë copa llastiku nga një kamerdare e vjetër që e mbante Pandua në shtëpi. U ngjitëm lart dhe te “dhomëza” e parë, ndezëm copat e kamerdares, që i mbanim në dorë, dhe zbritëm njëri pas tjetrit poshtë në “dhomëzën” e dytë. Për habinë tonë, edhe kjo lidhej, përmes një të çare, me një “dhomëz” të tretë. Zbritëm, dhe...në shurdhësinë e heshtjes, ndiem një lloj zhaurime ere të freskët dhe një zhurmë të mbytur që i ngjante gurgullimës së ujit. Mora një guriçkë, e hodha poshtë të çarës dhe prita. U dëgjua një “bllum”. Hodhëm të gjithë guriçka dhe u bindëm se poshtë kalonte ujë. “E gjetëm!”, thërritëm njëzëri, por, nuk kaluan shumë sekonda kur po ndienim vështirësi në

frymëmarrje. Ishim fëmijë, pa përvojë për të kuptuar se tymi që dilte nga djegia e copave të kamerdares, futej në mushkëritë tona dhe në mungesë të ajrit të pastër, përbënte një rrezik serioz. Po na merreshin mendtë dhe po na mpakeshin forcat... Instinktivisht mbështetëm njëri-tjetrin, dhe me shumë vështirësi dolëm në zgavrën e parë, dhe kjo e mbushur me tymin që dilte nga copat e djegura të kamerdares...

Jashtë shpellës, përfund atij shkëmbi nga damarët e të cilit buronte lumi, u shtrimë për të marrë veten. Shikonim njëri-tjetrin dhe qeshnim. Fytyra të nxira dhe tesha të ngjyera si me bojë të zezë. Ishim bërë *helaq*, siç thoshin gjyshet tona kur ktheheshim në shtëpi të baltosur apo të pluhurosur. Po s'donim t'ia dinim, madje as për të bërtiturat e grave që ishin te lumi, kur na panë me këtë pamje "lugati". Na lau lumi... Rëndësi për ne kishte fakti se ishim të parët, sipas nesh, që eksploruam vendburimin kryesor të Bistricës.

ME Ç'BOJË T'I BËJ KËPUCËT?!

Rrugët ishin të paasfaltuara dhe transporti publik shumë i “shtrenjtë”, në kuptim të vështirësive në sigurimin e biletave të udhëtimit. Nga Saranda apo Delvina nuk kishte linjë direkte për në Tiranë, dhe neve na duhej të shkonim në Gjirokastrë, madje herët në mëngjes, për të zënë radhën te porta e agjencisë, sepse biletat kishin një limit. Ndodhte që nuk e siguronim dot biletën dhe na duhej të qëndronim edhe një ditë më shumë në këtë qytet, dhe të udhëtonim drejt kryeqytetit ditën e tretë a të katërt.

Ime më më çoi herët, kur as gjelat nuk kishin çelur sytë e as nuk kishin shkundur pendët për të nisur më pas këngën e zgjimit... U vesha me nxitim, në gjysmerrësirë, pasi kandili, që nëna kishte ndezur në kuzhinë, lëshonte një fashë drite tepër të zbetë. U dëgjua që larg boria e makinës me të cilën do të shkoja në Gjirokastrë; vesha këpucët, zbrita shkallët e gurta të shtëpisë dhe vrapova nëpër errësirë. Ishin ditët e fundit të gushtit. Mëngjeset ishin të ngrohta dhe ditët shumë të nxehta. Te porta e agjencisë, ishte vendosur një njoftim që bënte me dije se biletat ishin

shitur, dhe se shitja e biletave për ditët në vijim do të fillonte pas orës 10:00. Ç'të bëja? Ishte ende herët për të shkuar te sporteli i agjencisë. Dielli, që kishte pushtuar jo vetëm “Çajupin”, por dhe fushën e lagjet e poshtme të qytetit, ende nuk kishte mbërritur te sheshi i “Çerçizit”, ku ecejaket në të gjithë hapësirën e tij, shtynin orën në pritje për t’iu afruar sportelit të biletave. Isha i ri dhe, si të gjithë të rinjtë, më pëlqente e bukura te vetja për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve, sidomos të vajzave, ndaj dhe më krijonte një ndjesi kënaqësie, madje habie, fakti, që atë mëngjes kalimtarët më shikonin me kureshtje, sidomos vajzat që nxitonin për në punë. Më shikonin duke mos e fshehur një të qeshur, të pakuptimtë për mua. Nuk e kuptoja arsyen, por thosha me vete: “mbase pamja ime e jashtme me këtë bluzë të re, ngjyrë të verdhë, që kam veshur”. Në fakt bluza të tilla nuk gjendeshin nëpër mapot e vendit. Ma kishte sjellë im vëlla nga Polonia, ku ishte specializuar në një kurs dyvjeçar për hekurudha, i dërguar nga shteti. Ishte kthyer në muajin qershor, kur viti shkollor numëronte ditët e fundit të tij. Një bluzë e re, e jashtme, ishte gjë e rrallë për mua. Ishte dita e parë që e kisha veshur dhe vetja më dukej superior nga veshja, mbi të tjerët. Kjo ishte shumë për mua, nxënësin-konviktor, që e kisha ëndërr të vishesha një herë me rroba të mira, si shumë djem të “jashtëm”, ose jo konviktorët, siç i quanin ne. Ishim shumë fëmijë në familje dhe prindërit nuk mund të na i plotësonin nevojat tona për ushqim e

veshje, ndaj u rritëm nëpër konvikte dhe u shkolluam me bursë shteti...

Ecja poshtë e lart sheshit të “Çerçizit” dhe mendjen e kisha atje. Kisha shumë ëndrra, që në mendjen time zbërtheheshin në plane për vitin e fundit të shkollës: organizimin e grupit amator të estradës dhe teatrit të degës, por dhe të shkollës, organizimin e mbrëmjeve të vallëzimit, ekskursioneve në Dajt, konkurset e higjienës dhe shpalljen e dhomës më të pastër dhe më të mirëmbajtur në konvikt... Bashkë me Zihniun, fizarmonicistin e talentuar nga Përmeti, Merzemen nga Berati dhe një grup shokësh dhe shoqesh konviktore e të jashtëm, ishim siç na thoshte kujdestar Mezani, zembereku i shkollës. Viti i katërt dhe i fundit do të ishte, natyrisht, më i bukuri, ndaj mezi prisja sa të fillonte shkolla.

Isha përhumbur në mendime për rrugën e së ardhmes, dhe ëndrrat për të nesërmen më jepnin kënaqësi...

Nga mendimet më shkëputi një zhurmë, pastaj thirrjet e lustraxhinjve. Në krye të sheshit, atje ku niste rruga e kalldrëmtë, që të çon te “Qafa e Pazarit”, ata kishin vendosur “mjetet e punës”, dhe po ftonin kalimtarët, duke përplasur furçat me njëra-tjetrën, si për të thënë “jemi këtu”, e duke thirrur: “Lustra, lustra. Hajde... këpucë me bojë, të vijë kush të dojë”... “T’u jap një bojë këpucëve”, thashë, pastaj të shkoj për bileta. Lustraxhiu i parë (ishin tre në radhë), u ngrit dhe më ftoi të ulesha. - Hajde djalo, ta bëjmë

sefte, mbase ke këmbën e mbarë, - tha, dhe më tregoi karrigen. U ula dhe vura këmbët te ndenjësja e lustrës në pritje që ustai të fillonte nga puna. Isha krejt i pavëmendshëm në lëvizjet e tij, dhe nuk e kuptova pse edhe ai qëndronte i heshtur, duke më parë nga poshtë në sy me një habi, që nuk e kisha ndeshur në asnjë rast tjetër.

- Ç'pate?! Vazhdo se nuk kam kohë të pres, - thashë i kapardisur. Ai vazhdonte të më shikonte, pa folur. Qëndrimi i tij më bëri përshtypje, prandaj e pyeta nëse do të m'i lustronte këpucët apo të ikja. Dhe ai, me një zë pyetës tha:

- Po, mor, po. Po si...

- Si posi, - ia ktheva me një ton qesëndisës.

- Me ç'bojë t'i bëj, me të kuqe apo me të zezë?

- Tallesh? - e pyeta. Pastaj i thashë: - Me bojën e këpucëve!

- Dakord, dakord, po... ke një këpucë në ngjyrë kafe dhe një të zezë, - më tha.

Ula sytë, për herë të parë pas daljes nga shtëpia, në agim të asaj dite, pashë këpucët dhe ndjeva të më digjinin faqet, mbase më ishin skuqur prej turpiti. U hodha nga karrigia dhe pa thënë asnjë fjalë ia dhashë vrapit pa marrë frymë, deri poshtë në rrugën nacionale, për t'u kthyer në fshat.

Si të gjitha fshatrat edhe Muzina nuk kishte energji elektrike në fillim të viteve '60. Elektrifikimi do të vononte që të ndodhte, ndaj kandili dhe fenerët (ishte një luks po të kishe një të tillë në shtëpi) ishin mjeti

ndriçues, edhe pse shpesh, mungesa e vajgurit, që ishte me racion, i linte fshatarët krejt në errësirë. Errësira më çoi edhe mua në Gjirokastrë me një palë këpucë dyngjyreshe. Kisha veshur një këpucë të babait, duke e lënë edhe atë në pritje për të shkuar në punë.

Kortezhi me të ndjerën, pas përfundimit të shërbesës në kishë, u nis drejt varrezave që ndodheshin poshtë rrugës nacionale. Kortezhit i printe prifti, me kokën zbuluar pa kamillafin e zi, që gjatë gjithë rrugës tundte temjanicën, nga ku tymi me erën karakteristike të temjanit shpërndahej, duke i dhënë këtij procesioni gjithë solemnitetin e një riti mortor, siç ndodh në çdo përcjellje drejt banesës së përhershme të të dashurve të këtyre banorëve që ikin nga kjo botë. Pas arkivolit ecnin gratë, veshur në të zeza, dhe të heshtura si gur varri. Pas tyre burrat, që, siç ndodh gjithnjë në përcjelljet mortore në Muzinë, nuk preferojnë futjen brenda në kishë; e pritën arkivolin te porta e varrezës dhe e ndoqën kortezhin gjer në vendvarrim. Ata lëvizin kokulur, por jo pa fjalë, dhe të shpërndarë në grupe ndjekin nga larg fjalët shprese dhe ngushëllimi të priftit, si: “bija ime, ti je thirrur në një thirrje të lartë e të shenjtë... të bësh punën e Zotit...”, dhe më tej: “Qëndro besnik dhe ti do të bekohesh, madje do të jetosh derisa ta përfundosh punën tënde”, etj. Pastaj dedikimet e familjarëve për të ndjerën.

Thimjua, krejt indiferent për gjithçka ndodhte aty te vendvarrimi, e kishte përqendruar vëmendjen dhe shikimin në atë që po ndodhte pranë këmbëve të tij. Një mizë ishte rrëzuar përdhe; e kishte të pamundur të fluturonte gjer në “shtëpizën” e saj - s’ dihet se në cilin park bletësh të fshatit. Ajo përpëlitej mbi një copë sfungjeri të lagur nga shiu i rrëmbyeshëm, që kish rënë më herët dhe në pamundësi të lëvizte, nga era dhe të ftohtit, po shkonte drejt vdekjes. Ai u përkul dhe mori bletën nga sfungjeri mbi tokën e ftohtë të këtyre ditëve të marsit, thuajse të pjetë. E vuri në pëllëmbën e dorës. I bashkoi dy pëllëmbët duke e mbyllur bletën mes tyre dhe nisi ta ngrohte me frymën e tij. Atje tej i jepej lamtumira së bekuarës e së adhuruarës të Zotit, këtu luftohej me vdekjen, jo për të shpëtuar një njeri, por një qenie, krijesë së natyrës.

Avujt, e dalë në një frymëmarrje të nxituar nga goja e njeriut human, e ngrohën mizën, ajo doli nga “koma” që kish rënë, dhe filloi të lëvizë nëpër sheshin e pëllëmbës, të cilën Thimjua e mbante lart për t’i dhënë mundësi mizës të niste fluturimin. Dhe kjo ndodhi. Ata që e vrojtonin këtë skenë me kërsërinë e njeriut, që nuk e ka ndjesinë e dhemburisë për fatin e jetës së një blete, madje e shikonin veprimin si një marrëzi e absurditet, thanë gati njëzëri: “shpëtoi”. Vetëm kaq, dhe nisën biseda të tjera. Për ta asgjë e veçantë s’kishte ndodhur, kjo sepse askush nuk e kishte një shpirt që t’i dhembte aq sa për njerëzit e larguar nga kjo botë dhe për çdo gjallesë, që fati, vetë

natyra, apo dora e njeriut ngrihet mbi to. Thimjua, mjeshtri bletërritës, është njeriu që i ka kushtuar jetën dhe gjithë diturinë e tij bletarisë. Bletët ai i sheh jo si numër, që plotësojnë ushtrinë e një zgjoi, por si jetë që duhen mbrojtur nga çdo grabitqar dhe nga vetë natyra e papërshtatshme për to...

Shërbesa e varrimit mbaroi, dhe pasi doli personi me veglat e punës, sipas zakonit, dolën dhe njerëzit të prirë nga prifti, u vendosën në radhë për të takuar të afërmit e së ndjerës, me përqaftimet dhe thëniet e zakonshme: “të rroni vetë, të rrojnë të pasmit!”. Një e lamë atje nën dheun e ftohtë, në dorë dhe përkujdesje të Zotit, por edhe një jetë u shpëtua. Ky paralelizëm më erdhi ndër mend ato çaste dhe, ndryshe nga të tjerët ia shtrëngova dorën Thimjos, pasi veprimi i tij m’u duk sa human, aq dhe jo i zakonit. “Edhe jetëve jonjerëzorë mund t’u japim një shans për ta rinisur jetën”, i thashë bletarit të fshatit, “Po, - tha ai, - besoj në thënien se kur mendojmë se kemi arritur fundin, atëherë gjejmë forca për t’u ngritur sërish. E besoj këtë jo vetëm për vete dhe për ne, njerëzit, por dhe për çdo gjallesë që ecën mbi tokë apo që fluturon lart në qiell.”

“DIMRI I MADH” I MUZINËS

Ishte janari i vitit 1944. Dimër me rrebeshe shiu dhe bore, por dhe me rrebeshe plumbash. Ishim në luftë. Në një nga ditët e fundit të atij muaji e braktisëm shtëpinë dhe u larguam nga fshati. Jo vetëm ne si familje. Ishte një ikje fshatçe. Shumica e familjeve u strehuan në Dhrovjan, ku gjermani nuk ishte i pranishëm me trupa, të tjerë nëpër të njohur a lidhje fisnore, të shpërndarë nëpër fshatrat e tjera të zonës, nga Livina deri në Navaricë e Dhivër. Ne, si familje, shkuam në Sirakat, ku kishim njerëzit tanë. Isha i vogël, fare vocërrak, dhe nuk mbaj mend thuajse asgjë nga vuajtjet e asaj dite e më tej. Më kujtohet vetëm ai çast në mbërritje te shtëpia pas kthimit në fshat, kur dëgjova ulërimat e manas (mëmës) dhe të gjyshes. Nuk e kuptoja pse qanin dhe shkulnin flokët e kokës mbi pirgun e gurëve aty ku ishte shtëpia dhe që, çuditërisht, nuk ishte më shtëpi, por një grumbull gurësh. Vetëm kjo skenë më ka mbetur në kujtesën time pamore, dhe e sjell në mendje edhe sot në këtë moshë madhore. Ato ditë shkurti e marsi në fshat dëgjoheshin vetëm mallkime e sharje për

“dushmanin” (gjermanin), por dhe thirrje solidariteti për të mbështetur dhe ndihmuar njëri-tjetrin për të kaluar katastrofën. Ai fundjanari, por dhe muajt e mëpasmë të vitit 1944, u pagëzuan si “Dimri i madh” për Muzinën, e përfshirë, thuajse fshatçe, në luftën kundër pushtuesit.

Petro Lula, një nga veprimtarët e rinisë dhe pjesëtar i “njësimit gueril” të fshatit, shumë vite më pas do të na tregonte gjithçka kishte ndodhur. Te rrapet, poshtë shkollës, ku kishte një copë shesh ku grumbullohej fshati në ditë festash a mbledhjesh, dhe ne, kalamajtë, luanim me topa lecke të ndarë në skuadra sipas mëhallëve, e rrethuan një ditë Lalo Petron, (kështu e thërrisnim) këtë burrë që buzët nuk i qeshnin kurrë dhe serioziteti sikur i kishte mbirë mbi fytyrën e kuqërremtë. Na afroi pas vetes, dhe pasi na pyeti me radhë se të kujt ishim, hodhi vështrimin tej, drejt perëndimit ku dukeshin kungjet e kuqërremta të Pecës, sheshet, vreshtat, faqja jugore e Malit të Gjerë, dhe më tutje fshati dhe rruga që gjarpëronte përfund malit gjer tutje në Tabor. Pastaj shtriu dorën në atë drejtim, dhe tha se kjo rrugë ka parë shumë ushtri armike, italiane e gjermane, por edhe betejat që kanë zhvilluar partizanët me to. Muzina ishte një pikë strategjike, prandaj italianët, por sidomos gjermanët, më pas, do të vendosnin këtu forca për të garantuar

rrugën dhe urat... Fliste ngadalë dhe me një zë gërvishtës, por tingëllues. Heshti për një moment, dhe ne, kureshtar deri në padurim, e pyetëm gati njëzëri: “po fshati si u dogj...”

Ishte janari i vitit 1944, 17 janari i atij viti kur partizanët sulmuan dhe shkatërruan forcat xheniere gjermane që mbronin urat. Beteja u zhvillua në urën e Maçit. “Ja, atje tej, - tha, duke shtrirë dorën. - Urrën e zunë partizanët, dhe ne u morëm gjermanëve, që ia mbathën, shumë armë e municione. Nuk vonoi dhe gjermanët erdhën përsëri me forca të shumta dhe vunë nën kontroll rrugën me mision sigurimin e saj për lëvizjen e trupave, si dhe gjurmimin e veprimeve tona për moslejimin e komunikimit dhe të furnizimeve me ushqime e veshmbathje të reparteve partizane që vepronin në këtë zonë. Këtu ku jemi tani, gjermanët kishin një pikë vrojtimi. Ishte dislokuar një togë me ushtarë të armatosur mirë. Shkollën, këtu lart, e kishin kthyer në kazermë. Por nuk ndenjën shumë, dhe as ia dolën që të pengonin komunikimin tonë me partizanët. Atë javë toga gjermane u sulmua. Partizanët, të ndihmuar edhe nga fshatarë të armatosur, nisën aksionin në mesnatën e 24 janarit, duke goditur në befasi dërgesën gjermane të vendosur në shkollën e fshatit. Në errësirën e natës gjermanët ia mbathën poshtë shkollës dhe këtyre rrapeve; jo të gjithë shpëtuan. 7 gjermanë mbetën të vrarë. Partizanët morën gjithçka që ata lanë: armatime, municione, ushqime etj...” E ndërpreu këtu tregimin.

Nxori paketën dhe ndezi një cigare. Për ne, fëmijët e këtij fshati me histori lufte dhe traumash të mëdha, ky njeri ishte gjithkushi: partizani i djeshëm dhe njeriu i gjithëpushtetshëm i pasluftës. I tillë ishte dhe do të mbetej në përfytyrimin tonë. E thithi cigaren disa herë, duke e shtyrë tutje tymin për ta larguar nga ne dhe na tha se fshati e pagoi shtrenjtë atë fitore të partizanëve, se vërtet u shpartallua toga gjermane, por kjo do t'i egërsonte gjermanët, që derdhën egërsinë, jo mbi partizanët, por mbi fshatin, që sipas tyre, por dhe ballistëve, që bënë punën e kallauzit, nuk ishte mikpritës, por “një farë e keqe”, prandaj do të ktheheshin prapë, por tani si zjarrvënës.

“Komanda gjermane në Delvinë lëshoi urdhrin për shkatërrimin e fshatit. Erdhën këtu gjermanë e ballistë bashkë, dhe urdhëruan largimin e banorëve. Mblodhën të gjithë të moshuarit, që nuk mund të ndiqnin familjet e tyre dhe i mbyllën te shtëpia e Gabicit, ja atje në krye të mëhallës, në kodër, - tha ai duke vijuar tregimin. - Është e vetmja shtëpi në këtë fshat, që shpëtoi pa u djegur dhe u hedhur në erë. Janari ende nuk i kishte mbyllur të plotat ditët, kur forca speciale e repartit xhenier gjerman, minoi gjithçka dhe me një komandë hodhi në erë fshatin. Edhe ato mure që mbetën pa u rrëzuar, u rrafshuan me artileri. Mbi 950 banorë e lanë fshatin. Disa ikën nëpër qytete të tjera, dhe më të shumtit u strehuan në fshatrat përreth. 150 shtëpi u bënë gërmadhë. Mbetën pirgjet e mëdha me gurë, tymi dhe hiri i zjarrit.

Edhe rrugët dhe rrugicat nuk dukeshin. Fshati nuk ekzistonte...”

Vite e vite më pas fshati do të ringrihej. Me ndihmën e shtetit nisi rindërtimi i shtëpive me gurët e shtëpive të rrënuara, dhe shumica pa çimento. Shtëpitë i ngjanin njëra-tjetrës: Secila me dy dhoma, një sallon dhe me katua poshtë, me mure guri dhe të mbuluara me pllaka guri, që skuadrat e të rinjve vullnetarë të fshatit, i transportonin me kafshë nga mademet (vend ku nxirreshin pllakat) e Grapshit dhe Jorgucatit. Edhe sot ato shtëpi, që i kanë rezistuar furtunave të eksodeve, i japin Muzinës veçantinë dhe uniformitetin, që nuk e gjen në fshatrat e tjera. Po fshati nuk u bë siç ishte, sepse gati gjysma e shtëpive u rindërtua, të tjerat mbetën gërmadhë, sepse banorët e tyre nuk u kthyen më.

Mbi 90 familje do ta linin fshatin, shumica e të cilave do të shkonte në Tiranë, më pak në Durrës e në Vlorë, dhe mbi 20 familje në Sarandë e në Delvinë. Fshati i përgjysmuar mbeti me rreth 70 shtëpi, të rindërtuara, nga 150 që ishin para djegies. Muzina nuk do të përjetonte vetëm këtë “Dimër të madh”, të fillimvitit ’44, por dhe shumë “Dimra...” të tjerë, derisa mundi të ringrihej, dhe jeta të niste normalisht, më e qetë, e sigurt, dhe ndonëse në varfëri, më e bukur për kohën.

Vasil Çiko, oficer në lirim, do t'i drejtohej dekada më pas ambasadës Gjermane në Tiranë, në emër të shoqatës “Muzina”, përmes së cilës i kërkonte që qeveria e atij vendi të mund të kontribuonte sado pak në përmirësimin e infrastrukturës rrugore të fshatit, dhe të ofronte një dëshmipërblim për dëmet e shkaktuara. “Na takon, - thoshte ai, - pasi jemi i vetmi fshat, pas Borovës, që jemi dëmtuar më shumë.” Por, me sa duket, nuk mjaftonte vetëm dëshira, vullneti, dhe këmbëngulja e një individi apo e një shoqate. Duhej edhe ndërhyrja e strukturave të shtetit, dhe mbi gjithçka predispozicioni, qoftë dhe formal i Ambasadës, e cila heshti. Ishte një heshtje vrastare, që muzinjtët e përkthyen kështu: “Ishim në luftë. Ju na vratë, ne morëm hak”.

FSHATI ME SY TË PËRLOTUR

Sa vite e shekuj ka gjalluar jeta në këtë fshat? Im atë thoshte se “lashtësia i lë gjurmët në objekte të ndërtuara nga dora e njeriut”. Dhe, Shën Thanasi është kisha që ruan këto gjurmë. E vjetër në disa breza, por jo aq, mendoj, sa të jetë pikënisja e jetës këtu... Duke udhëtuar në kohë kam parë njerëzit e këtushëm në pasqyrën e ditëmirës dhe gëzimit, por dhe në pasqyrën e ditëkeqes, pra në ditë zie e dëshpërimi. Jeta këtu askurrë s’ka qenë njësoj. E djeshmja nuk i ngjan së sotmes...

Shumë dhimbje u ka shkaktuar jeta muzinjotëve ndër vite. Lufta i dogji dhe i la pa shtëpi, sepse gjermani u hakmor për rezistencën e tyre. U rropatën sa ngritën sërish një strehë dhe rifilluan jetën, por me lot në sy ngaqë fshati u zbraz nga ikjet e shumta. Pastaj kooperativa, që nxiti të tjera ikje, dhe më pas përmbysja, kur ndarjet e prindërve nga fëmijët e paralajmëruan fshatin për një vdekje të ngadaltë, vdekje brenda botëve të tij.

Jam këtu, i ulur te ballkoni i shtëpisë, që sot nuk mund të thuash se është shtëpi. Ky është ballkoni i fëmijërisë sime, që mban fshehur kujtime e mbresa të shumta. Është ballkoni me shkallët e gurta, që zbresin në oborrin nga ku niste rruga që bashkonte dy lagje të fshatit. Shkallët dhe ballkoni me histori fëmijërie dhe përjetime të dhimbshme, kur kujtoj time më, që gjeti vdekjen në moshë të thyer nga rrëzimi nëpër këto shkallë të gurta, që sot më ngjallin nostalgji e trishtim bashkë. Në këtë shtëpi, që vetëm ca mure dhe ky ballkon i kanë mbetur, rrënuar sa nga shirat dhe furtunat e viteve, aq dhe nga mungesa e frymëve njerëzore, kam lënë një pjesë të zemrës sime. Është streha e nostalgjisë për kohën e shkuar.

Sa herë kthehej i lodhur nga punët e rënda në kooperativë, im atë e gjente çlodhjen i ulur në këto shkallë, duke soditur gjelbërimin në pllajën përballë. Dhe më pas, në vetminë e tij, priste po aty. Shpesh e gjeja në dremitje dhe ai ngrihej të më përqafonte. “Erdhe?”, thoshte të vetmen fjalë, që për mua kishte domethënien e një brengje brenda shpirtit të tij. Dhe cili prind nuk i do fëmijët pranë? Në ato të pakta shtëpi, me të moshuar prindër-gjyshër të fshatit, jeta kishte të njëjtin ritual. Këtë e dija, dhe pyetja: “U mërзите?”, që i bëja tim ati, kishte gjithnjë të njëjtën përgjigje joreale: “Jo”. Im atë fliste pak dhe asnjëherë nuk shprehte atë që ndiente, as dhimbjet e shpirtit. “Kini edhe ju halle... fëmijët të bëjnë të vuash edhe kur i ke pranë, dhe më shumë kur janë larg”, më thoshte sa

herë justifikoja mosvajtjen për arsye të punëve të mia të “shumta”. E dinte dhe e pranonte faktin se fëmijët nuk mund të rrinë “rob të prindërve”, realitet ky që dukej qartazi në fytyrën e tij të trishtë.

... Atë dimër kishte rënë shi me rrëmet, aq sa rrëketë në zbritje nëpër rrema, lugje e lugajat e rrëpirave të malit krijonin rrjedha të rrëmbyeshme dhe frynin, si asnjëherë tjetër, shtratin e përroit që kalonte poshtë shtëpisë. Ai dimër, që dukej se nuk e kishte një fund, i mori jetën edhe rrapit shekullor disa dhjetëra metra i lartë dhe trungtrashë sa tre pashë njerëzish bashkë. Pllaja përballë shtëpisë, nga ku im atë sodiste gjelbërimin e saj, do të zhdukej sa hap e mbyll sytë. Një gjësim i frikshëm kishte nxjerrë njerëzit nga shtëpitë, dhe ajo që ata panë, pas atij gjësimi, ishte eremia e atij vendi të gjelbëruar, që i ngjante, paskëtaj, një kafshe gjigante të gjakosur. Mijëra metra - kub dhe, të fryra nga lagështia e tepërt, u shkëputën nga pllaja dhe u lëshuan me vërtik në atë rrëpirë, duke e vënë përfund rrapin shekullor, dhe duke tjetërsuar mjedisin bashkë me rrjedhën e përroit. Nuk më besohej ajo pamje dhe qëndrova çaste pa lëvizur ditën që e pashë shpatin e kodrës së rrëzuar; kërkoja me sy pyetës rrapin përfund atij masivi të pamatë dheu. “Ka vdekur, - tha im atë, dhe shtoi: - çdo gjë e ka një fund”. Kaq tha, dhe heshti. E përjetonte brenda vetes dhimbjen që i shkaktonte vetmia.

Tani rrapi i stërmadh poshtë shtëpisë jeton në kujtimet e atyre pak njerëzve që kanë mbetur. Po sa janë ata? Kur përcollëm në banesën e fundit tim atë, pas drekës së përmortshme në nder të shpirtit të tij, u mblodhën ca burra dhe nisën të bënin llogaritë: Sa banorë kishte fshati para luftës dhe sa pas luftës. Sa fshatarë kishin emigruar para lufte dhe sa familje dhe djem të fshatit kishin migruar brenda vendit. Kush nga burrat, punonte në kooperativë bashkë me gratë dhe vajzat, që bënin edhe punën e burrave që kishin një punë në qytet, dhe ktheheshin mbrëmjeve në fshat. Cili burrë apo grua ka qenë më jetëgjati, dhe, si me shaka, caktonin radhën e njëri-tjetrit për të ikur nga kjo botë. “Do ikim një ditë dhe porta e shtëpisë do të mbyllet pas nesh. Askush s’ka për ta hapur”, u thoshte Nashua, dhe numëronte djemtë e vajzat e larguar në kurbet. “Oh sa shumë! Ikën të gjithë. Ikën dhe na lanë ne, po sa do të rrojmë?”, thoshte... Ai, Miçua, Vasili, Andoni, Rakua, Kristofori, për të mos i shkuar gjer në fund listës, i mungojnë fshatit sot. Shumë dyer janë mbyllur, dhe shtëpitë e mbetura me pak njerëz të lodhur nga vitet dhe pritja, me sytë e përlotur dhe vështirimin e shpresës nga rruga, janë dëshmi e dramës së madhe të vetmisë.

Prej ballkonit të shtëpisë së fëmijërisë sime, i ulur tani në moshë të thyer, me nostalgji për vitet që

kaluan, përjetoj ngjarjet dhe njerëzit protagonistë të tyre, si t'i shoh nga nënballkoni i syve. Është malli për atë që ke lënë pas dhe malli qenka vërtet një përbindësh i keq. Për të ardhur gjer këtu më duhet të çapitem disa dhjetëra metra rrugë përmes shtëpive të lagjes, dhe askush nuk më del përpara të më urojë mirëseardhjen, a të më pyesë për shëndetin, si bënin dikur njerëzit e këtushëm me ardhësit dhe mes vetit, që edhe në distancë, madje nga një lagje në tjetrën, përcillnin mesazhe urimi, apo qanin hallet e ditës. Një heshtje vrastare kjo e sotmja, e ngjashme me atë të gurëve të varrit...

Ata të paktë, që kanë mbetur, jetojnë pa u dukur, edhe pse do të donin që e sotmja e tyre t'i ngjante sadopak së djeshmes së zhurmshme. Ndodhte kjo kur mblidheshin në festa, të cilave sot u mungojnë njerëzit. Ndaj tani ka më pak organizime festash e më shumë ceremoni varrimi, dhe në ditët mortore njerëzit bisedojnë më shumë me heshtjen, sesa mes tyre. Kur ishte Koçi kryeplak, diçka lëvizte në fshat. Dëgjoheshin edhe lehjet e qenve, që shkonin pas tufës së madhe të dhive që ai mbarështonte. Vite të shkuara ai vendosi të kultivonte perime, ndaj hapi një copë tokë poshtë në bostane, ku dekada më parë fshatarët mbillnin domate. Bleu dhe një traktor të vogël, por edhe pompë për të marrë ujin e burimit te kroi. Prodhoi disa vite atje, domate, specat dhe të tjera perime, po nuk e kishte menduar mungesën e tregut. Ku do ta çonte prodhimin? Ata pak banorë të fshatit mbillnin

në bahçet e tyre aq sa ç'mund të konsumonin, kështu Koçit i mbeteshin vetëm ca pak klientë të moshuar, që nuk mundnin ta punonin tokën. E pa që nuk kishte leverdi, ndaj e braktisi tokën. Bleu disa dhi, dhe, në vite, e shtoi numrin e tyre deri në një tufë në dhjetëra krerë... Tani, si dëshmi e gjithë atij mundi, ka mbetur kasollja e dhive, që Koçi e kishte ndërtuar pak metra larg “vendvarrimit” të rrapit shekullor. “Do të ikëj, - më tha një ditë. - Kam fëmijët e vegjël dhe këtu s'kanë të ardhme...”

Jam ulur këtu te ky ballkon dhe ëndërroj i zhytur në dhimbjen time të ëndrrave që kam lënë këtu, dhe sot s'i gjej. Dëgjoj këngën e gjinkallave në këtë vapë përvëluese të korrikut dhe asgjë tjetër. E shkuara nuk kthehet më, e bashkë me të as madhështia e rrapit “të vdekur”, as zërat lozonjarë të vajzave, dhe blegërimat e deleve në vathët e bagëtive pas kthimit nga kullota, as tingëllima e çangës, që thërriste mbledhjet e banorëve në qendër të fshatit, as zhurmënaja e kuisjet e fëmijëve të shkollës që zbrisnin, në pushimin mes orëve të mësimi, potershëm në sheshin e rrapeve në “Kodër”, as suharetë mbrëmjeve me rininë e fshatit dhe shfaqjet e estradës amatore që argëtonin fshatarët... Gjithçka i mungon së sotmes. E shikoj atë përmes syve të përлотur të tim ati dhe jo vetëm. Fshati me fytyrën e vet të trishtuar pikon lot malli për të ikurit, dhe njerëzit e moshuar brenda tij presin... Drita e shpresës, që kanë përbrenda, shpresojnë të mos u shuhet.

PREVENTORIUMI

Ishte takimi i fundit me të. Qëndronte i vetmuar në një stol të lulishtes në qendër të qytetit. Pinte cigare edhe pse mjekët, prej kohësh, e kishin këshilluar të hiqte dorë për të ruajtur shëndetin. E pashë nga larg dhe iu afrova. Kishte ulur kokën sikur të kërkonte diçka përdhe, tymoste duke mbajtur me gishtat e dorës që dridhej, cigaren që, edhe se në mbarim, nuk e hidhte. Nuk e di ç'mendonte i vetëm dhe kokulur, në atë stol në lulishten e qendrës së qytetit. Ndoshta kohën dhe vitet ku ka ecur, pasi njeriu në moshë të thyer e shpërfill të sotmen dhe më shumë jeton në të djeshmen. “Daut!”, i foli kur iu afrova. Ai ngriti kokën, dhe pashë t’i çelej një dritëz në sytë fshehur në qepallat e fryra, e t’i ndriste fytyra. Pastaj në buzëqeshjen e tij dallova dhëmbin e veshur me flori mes dhëmbëve të tjerë të zverdhur nga nikotina. Donte të çohet, por nuk e lashë. I hodha dorën në qafë dhe e përqafova. Nuk e kishte më atë shikim të zjarrtë, veç zërin po, si një tingëllim kumbues.

- Oh, sa më kishte marrë malli! - më tha.

- Edhe mua,... po pse vetëm? - i thashë. - Delvina është vend i ngrohtë jo vetëm se ka shumë diell,